



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Ariola Bacu
2. Prof. Dr. Adelaida Andoni

Prill/2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” ofruar
nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Bujqësor i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 468 datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr.15, datë 01.02.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14/9
18	Numri i studentëve: 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023	96, 61 dhe 26 studentë. Në total 183 studentë.
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) e ushtron aktivitetin e tij mësimor-kërkimor bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij, Strategjinë e tij dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. UBT ka një eksperiencë të gjatë në fushën mësimore e kërkimore. Programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” i ciklit të parë ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë dhe është pjesë e njësisë bazë të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky program ofrohet me kohë të plotë dhe është organizuar duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr. 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018”¹ dhe VKM Nr.185 dt. 25.03.2021²). Programi i ciklit të parë, Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” i përket nivelit 6 (gjashtë) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi është organizuar në 6 (gjashtë) semestra akademikë me nga 30 kredite (ECTS) secila. Programi i ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” zhvillohet me kohë të plotë në 3 (tre) vite akademike në gjuhën shqipe. Lëndët e programit janë të ndara në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, dhe lëndë ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas Udhëzimit të MASR Nr.41, dt. 24. 01. 2018. Aktualisht, Departamenti “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” ka në përbërjen e tij personel akademik prej 14 pedagogësh me kohë të plotë, nga të cilët, 3 (tre) Prof. Dr., 3 (tre) Prof. Asoc. Dr., 6 (gjashtë) Dr. dhe 2 (dy) MSc.

¹ https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_nr_41_date_24_1_2018_9fab9164a8.pdf

<https://fshn.edu.al/Info/vkm/notifications/nr-41-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte>

https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_Nr_879_date_18_12_2019_46b1a0c982.pdf

² <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/6.-vendim-2021-03-25-185.pdf>

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën **Prof. Dr. Ariola Bacu** dhe **Prof. Dr. Adelaida Andoni** si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL **Znj. Aleksandra Xhamo**.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” ofruar nga Univesiteti Bujqësor i Tiranës/Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë. Qëllimi i këtij raporti është të japë një vlerësim të pavarur për shkallën në të cilën Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë është i përgatitur dhe i angazhuar për të përmbushur standardet akademike të diplomave që lëshon. Për të arritur në këtë vlerësim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin bazohet veprimtaria e IAL (statuti, rregullorja, strategjia etj.), dosjen e programit të studimit, rregulloren e programit, dokumentacionin e sekretarisë mësimore si dhe takimet/vizitat të organizuara në institucion.

Më datë 23.03.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 38/38 Prot., datë 23.03.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 29.03.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 823/2 Prot., datë 30.03.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.1, Kriteri 6, GVJ vlerëson se Sektori i Karrierës dhe Alumnit funksionon/ekziston jo vetëm në nivel universiteti por edhe në nivel fakulteti. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.4, Kriteri 4, GVJ vlerëson se nevojitet dhe rekomandohet një përfshirje më e gjerë e studentëve të Programit të Studimit në projekte kërkimore. Rekomandimi mbështetet edhe nga GVB. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.1, Kriteri 5 dhe 8, GVJ konstanton se Tabela 2 ASCAL (kriteri 5) përmban informacionin e nevojshëm m në lidhje kualifikimin e personelit ndihmës akademik. Gjithashtu në mbështetje të kriterit 8 GVB ka përfshirë si evidencë shtesë, “Udhëzues të Praktikës Profesionale” (**evidenca IV.13**). **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.3, Kriteri 4, GVJ konstanton se GVB ka përfshirë si evidencë shtesë, “Ndarjen e literaturës së bibliotekës sipas fushave” (**evidenca IV.14**). **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë (statuti i UBT-së, Kreu I, neni 2, Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, Kreu III, neni 16 dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të UBT-së 2016-2025, evidencat I.0, I.11, I.15), Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, rezulton se programi i studimit, cikli i parë, Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ai synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare duke përgatitur ekspertë në shkencat e ushqimit dhe të ushqyerit.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar evidencave mbështetëse të RVB (statuti i UBT-së, Kreu I, nenet 2 dhe 3, Rregullore e UBT-së për Studimet Universitare, Kreu II, neni 3, Kreu 3, neni 18 dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të UBT 2016-2025, evidencat I.0, I.11, I.15), vihet re se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit të Universitetit të Bujqësor të Tiranës, synon të ofrojë programe rigorozë edukimi të cilat zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e studentëve duke ruajtur dhe konsoliduar vlerat akademike, kulturore dhe kombëtare në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Bazuar në Statutin (Kreu IV, neni 3) dhe Rregulloren (Kreu III, neni 16) e IAL (evidencat I.0, I.11) si dhe në Rregulloren e Programit (evidenca I.14), programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” ofrohet me synimin që të japi njohuri bazë mbi metoda të përgjithshme dhe parime shkencore si dhe aftësi specifike në një gamë të gjërë profesioneve dhe specialitetesh. Ai është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim (evidenca I.15, Plani Strategjik i Zhvillimit të UBT-së 2016-2025), të Statutit (evidenca I.0, Kreu I, neni 3) dhe Rregullores së Institucionit (evidenca I.11, Kreu III dhe IV, nenet 18-19) si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. Si i tillë, programi i përmbush kërkesat e kriterit 3.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike	Universiteti Bujqësor i Tiranës ka një aktivitet të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në fushën e bujqësisë (evidenca I.0, Statuti i UBT-së, neni 1, Themelimi i Institucionit). UBT është i përbërë nga 5 (pesë)

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>fakultete (evidenca I.0, Statuti i UBT-së, neni 11):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit • Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit • Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit • Fakulteti Shkencave Pyjore • Fakulteti i Mjekësisë Veterinare <p>UBT demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar (evidenca I.15).</p> <p>Referuar Tabelës 1 ASCAL Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ka në përbërjen e tij 3 (tre) departamente dhe një qendër kërkimore ku secili ka të paktën 7 (shtatë) anëtarë si personel akademik me kohë të plotë nga të cilët të paktën 3 (tre) me grada shkencore/tituj akademikë, si dhe personel ndihmës akademik (Evidenca I.0. Statuti i UBT-së, Kreu V, nenet 36,41) në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (LAL). Këtu përfshihet edhe Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit”.</p> <p>Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me standardet (Tabela 16 ASCAL).</p> <p>GVJ konstanton se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë përmbush plotësisht detyrimet e tij nëpërmjet stafit akademik të kualifikuar.</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Referuar planit mësimor (evidenca I.22), GVJ konstanton se programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është emërtuar sipas fushës së studimit dhe është i organizuar në 3 (tre) vite akademike (6-gjashtë semestra) me nga 60 kredite/vit (evidenca I.22).</p> <p>https://www.ubt-uni.net/sq/studimi/programet-bachelor/shkencat-e-ushqimit-dhe-teknologji/struktura-e-programit/</p> <p>Programi është strukturuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë (Ligji 80/2015), VKM Nr. 41, datë 28.01.2018 (evidenca I.19) dhe në përputhje me drejtimet prioritare akademike të UBT-së.</p> <p>Rregullorja e UBT-së (evidenca I.11 Kreu VIII, neni 50) eidenton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore e cila është përgjegjëse për programin e studimit. Programi ka qasje të plotë me kuadrin kombëtar, rajonal dhe BE (evidenca I.0 Kreu VII, neni 52, 53, 55).</p> <p>Kurrikula mësimore e njësisë kryesore eidenton se programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” përbëhet nga 5 (pesë) veprimtari formuese (Evidenca I.21, Kurrikula mësimore e njësisë kryesore):</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëndë bazë • lëndë karakterizuese të programit • lëndë ndërdisiplinore • lëndë plotësuese • lëndë përmblylëse e programit

	<p>Programi klasifikohet në nivelin 6, sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane që lejojnë transferimin apo vijimin e studimeve në IAL të tjera (evidenca I.20).</p> <p>https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/LIGJ-10247-2010-korniza-shqiptare-e-kualifikimeve.pdf)</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstanton se UBT ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit dhe Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë i cili është njësisia bazë përgjegjëse për programin e studimit, dhe që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Statuti, Rregullorja e UBT-së dhe Rregullorja e Njësisë Kryesore (evidencat I.0, I.11, I.12) evidencojnë se marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda UBT-së për mbarëvajtjen e programeve të studimit, organizohen dhe realizohen nga njësitë akademike, ndihmës-akademike dhe administrative, në strukturën e rektoratit.</p> <p>Organizimi në bazë fakulteti bëhet nga dekanati i çdo fakulteti (evidenca I.39, organigrama IAL, Njësi Kryesore), i cili miraton hapjen dhe organizimin e programeve të studimit, kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit, etj. Dekanati bashkërendon punën me Senatin Akademik të UBT-së për çështjet e sipërpërmendura. Çdo fakultet analizon dhe pasqyron çdo vit rezultatet e veprimtarisë së tij dhe departamenteve në varësi.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë konstatohet se për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve, IAL ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë institucione homologe.</p> <p>Kjo evidencohet nga marrëveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit të UBT-së me IAL të ndryshme (evidencat I.32, I.33, I.34), projektet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare (http://steps-project.eu/) (evidenca I.7 Rregullore mbi menaxhimin e projekteve), Bashkëpunimi me Universitetin Boku në Austri (evidenca I.44), Mobilitete (evidencat I.36, I.37, I.38, Mobilitete studentë dhe staf) etj.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore,</p>	<p>Evidencat e marrëveshjeve të cituara në kriterin 2 të këtij standardi mundësojnë zhvillimin e praktikave (evidencat I.32, I.33, I.34) nga IAL. Mbikqyrja e praktikave realizohet nga pedagogët udhëheqës të praktikave, të cilët dorëzojnë në departamentet relacionet përkatëse. Kjo</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	evidentohet nëpërmjet evidencës I.45 (Procesverbal praktike).			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njëسيا përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë ka përgatitur raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Kjo evidentohet në raportin e analizës vjetore të Departamentit për vitin akademik 2021-2022 (evidenca I.29).Raporti (analiza) është përdorur dhe përdoret për vlerësimin e ecurisë së programit të studimit.			
Konkluzione	<i>GVJ konstanton se UBT/Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, aktorë vendas dhe të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit si në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ai është bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018. Kjo evidentohet në planin e studimit (evidenca I.22).</p> <p>Programi Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është i organizuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (evidenca I.22). Plani mësimor realizohet në 3 (tre) vite studimi (6-gjashtë, semestra), me një numër total kreditesh 180. Lëndët mësimore janë të klasifikuara sipas veprimtarive formuese (Tabela 9 ASCAL, evidenca I.22).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion vihet re se programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” i ofruar nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë përmban lëndë bazë të fushës përkatëse të cilat i mundësojnë studentëve njohuri të përgjithshme teorike dhe praktike në fushën e Shkencave të Ushqimit dhe të Ushqyerit (evidenca I.22). Me këto njohuri studentët janë të aftë për të punuar në një shumëllojshmëri profesionale e specialitetesh, si në sektorin publik apo privat. Kjo evidentohet edhe në Planin Strategjik të Departamentit (evidenca I.17). Plani mësimor dhe programet lëndore (evidencat I.22, I.23) zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në fushën akademike ose profesionale, të cilat mundësojnë zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e shkencave të ushqimit dhe të ushqyerit.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar evidencave të RVB konstantohet se programi Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” përmban të gjithë elementët strukturorë në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore fuqi (evidencat I.22, I.23). Evidentohet nga plani mësimor dhe programet lëndore se programi i studimit të ciklit të parë i ka të grupuara lëndët sipas kategorive të përcaktuara (veprimtarive formuese), me ngarkesën përkatëse dhe përqindjen e krediteve në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është i organizuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (evidenca I.22). Plani mësimor realizohet në 3 (tre) vite studimi (6-gjashtë, semestra), me një numër total kreditesh 180. Lëndët mësimore janë të klasifikuara sipas veprimtarive formuese përfshirë realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse (punimi i diplomës) (Tabela 9 ASCAL, evidenca I.22).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UBT nuk klasifikohet si institucion e arsimit të lartë me status të veçantë.			
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018. Ai është i organizuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Programi i studimit të ciklit të parë realizohet në 3 (tre) vite studimi (6-gjashtë semestra), me një numër total kreditesh 180, të cilat janë në përputhje dhe ekuivalente me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në planin mësimor renditen lëndët mësimore (të klasifikuara sipas kategorive A, B, C, D, E), kreditet për secilën lëndë dhe detyrimet që ka studenti për to (Tabela 9 ASCAL, evidenca I.22). Si i tillë ai ka përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind me programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi.			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Referuar Statutit të UBT-së, neni 53 (evidenca I.0) konstantohet se programet e studimit të ofruara nga IAL janë të organizuara dhe grupuara në kode që identifikojnë fusha të ngjashme studimi në nivel kombëtar, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi nuk ofrohet në bashkëpunim me IAL te tjera.			
Konkluzione	GVJ konstanton se programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është organizuar në përputhje me LAL, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 si dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe	Referuar Tabelës 1 ASCAL konstantohet se Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ka në përbërjen e tij 3 (tre) departamente dhe një qendër kërkimore: <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë • Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

akreditimin.	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Kimisë • Qendra e Kërkimit të Ushqimit <p>Referuar LAL neni 25, konstantohet se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë përmbush detyrimet ligjore në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike. Departamentet/qendra kanë të paktën 7 (shtatë) anëtarë si personel akademik me kohë të plotë nga të cilët të paktën 3 (tre) me grada shkencore/tituj akademikë, si dhe personel ndihmës akademik (Evidenca I.0. Statuti i UBT-së, Kreu V, nenet 36,41) në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (LAL). Departamentet janë të organizuar në grupe mësimore të përbërë nga të paktën 5 (pesë) anëtarë personel akademik me kohë të plotë në përmbushje me detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ka Ushqimit ka në përbërjen e tij 3 (tre) departamente dhe një qendër kërkimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë • Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore • Departamenti i Kimisë • Qendra e Kërkimit të Ushqimit <p>Organizimi, funksionimi, dhe struktura e tyre është në përputhje me bazën ligjore në fuqi (LAL) e evidentuar kjo në Statutin (evidenca I.0, Kreu III, neni 19) dhe Rregulloren e IAL (evidenca I.11, Kreu II, neni 15).</p> <p>Departamentet/qendra kanë të paktën 7 (shtatë) anëtarë si personel akademik me kohë të plotë nga të cilët të paktën 3 (tre) me grada shkencore/tituj akademikë, si dhe personel ndihmës akademik (Evidenca I.0. Statuti i UBT-së, Kreu V, nenet 36,41, Tabela 1 ASCAL) në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (LAL).</p> <p>Departamentet janë të organizuar në grupe mësimore. Këto grupe janë të përbëra nga 5 (pesë) anëtarë te stafit akademik me kohë të plotë në përputhje me udhëzimin e MASR Nr. 27, datë 29.12.2017 (evidenca II.4) dhe drejtohen nga përgjegjësi i grupit. Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë është e përbërë nga 3 (tre) grupe mësimore-kërkimore (evidenca I.40, Vendim dekanati për ngritjen e grupeve mësimore-kërkimore):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkencat e Ushqimit dhe Nutricionit • Mikrobiologji dhe Bioteknologji • Biologji dhe Aplikimi i Metodave të Biologjisë Molekulare në Ushqime
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ vëren se koordinatori i programit të studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë. Roli dhe detyrat e koordinatorit të programit janë sanksionuar në Statutin e UBT-së (evidenca 1.0, Kreu VII, neni 17).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstanton se Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë</i></p>

	<i>përgjegjës për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si Ligji i Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë i cili është edhe departamenti përgjegjës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” disponon informacionet e nevojshme lidhur me organizimin dhe strukturën e programit. Këtu përfshihen plani mësimor, Rregullorja e programit dhe syllabuset e lëndëve, tarifat, kriteret dhe kuotat e pranimit (evidencat I.22, I.14, I.23, II.5, II.6).</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ai është bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018. Kjo evidentohet në planin e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve (evidenca I.22, I.23, Tabela 9 ASCAL).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është i organizuar në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (evidenca I.22). Plani mësimor realizohet në 3 (tre) vite studimi (6-gjashtë, semestra), me një numër total kreditesh 180. Lëndët mësimore janë të klasifikuara sipas kategorive A, B, C, D, E (Tabela 9 ASCAL, evidenca I.22).</p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë i cili është edhe departamenti përgjegjës për programin e studimit ka hartuar hartuar planin mësimor (evidenca I.22) ku përcaktohet ngarkesa mësimore në auditor dhe jashtë tij. Për çdo lëndë të programit ekzistojnë syllabuset përkatëse, të cilat përcaktojnë qartë frekuentimin/ndjekjen e programit nga studentët dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve të fituara (evidencat I.22, I.23, Tabela 9 ASCAL).
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ konstanton se Rregullorja e programit (evidenca I.14, Kreu II, neni 4,5) përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët si kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, ripranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (evidenca I.14).
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, u vu re se programi i studimit i ofruar nga ky departament është hartuar dhe organizuar në përputhje me kuadrin përkatës ligjor, VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. Ai përmban informacionin e nevojshëm për programet lëndore. Secila lëndë e këtij programi ka syllabusin përkatës, në përputhje me formatin e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përputhje me formatet e miratuara.	miratuar, që përmban informacion të detajuar mbi titullarin e lëndës, ngarkesën (leksione, seminare, laboratore, praktika, orët përkatëse dhe kreditet), tipologjinë e lëndës, vitin dhe semestrin kur zhvillohet (evidenca I.23, Tabela 9 ASCAL).			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ konstanton se Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë përmirëson dhe përditëson programet lëndore (Tabela 11 ASCAL) sipas përcaktimeve në Rregulloren IAL (evidenca I.11, Kreu III, neni 18).			
Konkluzione	<i>GVJ konstanton se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë të përcaktuara në kurrikulën e programit dhe programet lëndore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit përmban lëndë karakterizuese dhe integruese të cilat janë emërtuar, strukturuar dhe zhvilluar për t'u mundësuar studentëve njohuritë dhe aftësitë e nevojshme si edhe punësimin. Kjo konstatohet nga evidencat I.22, I.23. Lëndët janë shpërndarë në semestra dhe vite mësimore të ndarë në leksione dhe seminare si edhe të koordinuara me laboratorët përkatës, prej të cilëve studentët fitojnë shprehitë e nevojshme eksperimentale, mjaft të nevojshme në aspektin profesional dhe u mundësojnë atyre studime të mëtejshme dhe punësim (evidencat I.22, I.23).
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi i studimit Bachelor në "Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit" përmban lëndë me karakter të përgjithshëm (evidenca I.22, I.23, II.11, format i diplomës dhe suplement), të cilat synojnë t'i ofrojnë studentit informacion bazë dhe lëndë ndërdisiplinore si dhe lëndë të specialitetit. Nga syllabuset e secilës lëndë konstatohet se orët mësimore (leksione, seminare dhe laboratore) me shpërndarjen e krediteve përkatëse mundësojnë arritjen e objektivave formuese si dhe rezultate të pritshme të mësimnxënies.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Bachelor në "Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit" është i strukturuar në mënyrë të ngjashme me programet ndërkombëtare, në përputhje me sistemin Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Kjo konstatohet në planin mësimor dhe programet lëndore (evidencat I.22, I.23). Ngarkesa semestrale është e ekuilibruar përsa i përket shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesa totale vjetore është 60 kredite, duke respektuar raportin teori/praktikë (evidenca II.11, formati i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	diplomës, suplementi i programit).
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Referuar planit mësimor dhe programeve lëndore (evidencat I.22, I.23) konkludohet se Programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është i strukturuar në mënyrë të ngjashme me programet e të njejtit profil jashtë vendit dhe siguron një ndarje të drejtë të veprimtarive formuese (mësim në auditor; studim individual) dhe një raport efikas teori/praktikë. Programi është ngritur duke shfrytëzuar eksperiencat ndërkombëtare. Përsa më sipër, përshtatja e programit të studimit të ciklit të parë mundëson jo vetëm arritjen e objektivave formues por edhe mundësinë e transferimit të studimeve në universitete të tjerë brenda apo jashtë vendit (evidenca I.11, Rregullore IAL Kreu IV, neni 25). Me strukturën dhe ngjashmëritë me programet paralele të studimit në universitete të tjera, studentët jo vetëm që pajisen me formim të ngjashëm në këtë fushë por në këtë mënyrë atyre u mundësohet punësimi.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Referuar Rregullores së UBT-së (evidencat I.1. Kreu II) konstantohet se në fillim të çdo viti akademik, departamentet hartojnë planin mësimor të çdo viti duke mundësuar përmirësimin e programeve dhe rifreskuar programet lëndore edhe me literaturë apo botime bashkëkohore. Studentëve ju ofrohen materiale në gjuhën shqipe për profillin përkatës si edhe materiale ndihmëse në shqip ose gjuhë të huaj.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në planin mësimor dhe programeve lëndore (evidencat I.22, I.23) evidentohet se programi i ciklit të parë përmban lëndë bazë të cilat i mundësojnë studentëve një kulturë të përgjithëshme dhe lëndë profesionale të cilat i thellojnë dijet e studentëve në aspekte më të specializuara të profilit të shkencave të ushqimit (Tabelave 10, 11 ASCAL). Njohuritë e thelluara evidentohen nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare (evidenca II.13, lista e artikujve dhe konferencave me pjesëmarrjen e studentëve).
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Programi i studimit të ciklit të parë është i strukturuar në përputhje me sistemin Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Si i tillë, ai u mundëson studentëve të përfshihen në tregun e punës vendas apo të huaj ose për të vazhduar më tej studimet në Master Profesional/Shkencor, brenda (evidenca II.14, studentë të regjistruar në programet Master) ose jashtë vendit. <i>GVJ vlerëson se gjurmimi i studentëve kryhet në nivel institucional, në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. Referuar numrit në rënie të studentëve të regjistruar për vitin akademik 2022-2023, GVJ rekomandon studime më të thelluara të tregut të punës në nivel njësie bazë.</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstanton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit të ofruar nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, si dhe fitimit të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	UBT, Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë organizojnë Workshop-e me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni për të përmirësuar përmbajtjen e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kjo evidentohet nëpërmjet evidencës II.15 (evidenca II.15, workshop/takime). https://ubt.edu.al/2019/12/22/workshop-me-teme-studentet-dhe-tregu-i-punes/			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirëimit të programit të studimit.	GVJ konstanton se UBT ka vënë në dispozicion të studentëve zyrën e Life Long Learning (LLL) (evidenca II.15, dosje takimesh) e cila nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Në këtë mënyrë, Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirëimit të programit të studimit.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar Tabelës 5 ASCAL, GVJ konstanton se IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me fakultete/universitete brenda dhe jashtë vendit, si dhe me ente publike. Propozimet nga këto bashkëpunime apo zhvillimet e fundit në programin e studimit reflektohen në programet lëndore. GVJ konstanton se, në Rregulloren e brendshme të Njesisë Kryesore është saksionuar procedura e rishikimit periodik të programit të studimit (evidenca 1.3.1, nenet 90, 91).			
Konkluzione	GVJ konstanton se Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit/Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë përcaktuar qartë në programet lëndore (evidenca I.23) të programit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” dhe janë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë; VKM 41, dt. 24.01.2018). Format e mësimdhënies kategorizohen në leksione, seminare, laboratore, detyra kursi/projekte etj. (evidenca III.11, foto të prezantimeve të projekteve apo detyrave të ndryshme).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në programin e ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” janë ato konvencionale të kombinuara me aplikimin e formave alternative të mësimdhënies duke përdorur teknologjinë (video-projektor, laptop etj.). RVB raporton se metodat alternative dhe inovative të mësimdhënies e mësimnxënies u përdorën veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë për vitet akademike 2019-2020, 2021-2022, ku u vunë në zbatim platformat Google Meet/Classroom dhe Zoom për zhvillimin e mësimin online (evidenca III.1, III.12, udhëzues për zhvillimin e mësimin në distancë, komunikim nëpërmjet platformave online). Në këtë mënyrë, personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Mbështetja e IAL për personelin akademik në ndihmë të përmirësimit të kompetencave didaktike parashikohet në Planin Strategjik të Zhvillimit të UBT-së (evidenca I.15). GVJ konstaton se UBT mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit dhe objektivat formues të programit. Kjo evidentohet nëpërmjet infrastrukturës mësimore dhe kërkimore (evidencat III.8, III.9).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në programin Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” përbëhet nga staf akademik me kohë të plotë dhe staf akademik me kontratë. Bazuar në kualifikimet shkencore të stafit akademik të përfshirë në programin e studimit (Tabela 12 ASCAL, evidenca II.16, CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik), si edhe në materialet didaktike që përdorin vihet re kompetencë në transmetimin e njohurive dhe koncepteve (evidenca I.23, programet lëndore). Ky staf akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përshtatur sipas specifikave të lëndës (lëndëve) që drejton. Kjo evidentohet edhe nga mobilitet e stafit në vende të ndryshme të BE (evidenca I.38). GVJ vëren se metodat e mësimdhënies (detyra kursi, detyra individuale etj.) (evidencat I.23, III.11, III.12, programet lëndore, foto të prezantimeve</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	të detyrave të studentëve, komunikim nëpërmjet platformave online), pjesë e programit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” e inkurajojnë sensin e autonomisë tek studenti. Komunikimi i vazhdueshëm i stafit akademik me studentët ndihmon në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë pedagog-student.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nëpërmjet Këshillit Studentor (evidenca III.10) dhe raportit të analizës së pyetësorëve (evidenca III.7) u konstatua se personeli akademik i Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces.			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Referuar Tabelës 24 ASCAL konstatohet se UBT ka ngritur Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë e cila promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies Kjo njësi koordinon dhe bashkërendon me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Kjo evidentohet në programet lëndore (evidenca I.23). Studentët angazhohen në detyrat e kursit dhe ato individuale (evidenca I.23).			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UBT dhe Fakultetit i Bioteknologjisë dhe Ushqimit garantojnë procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor duke vënë në përdorim metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, për sigurimin e arritjeve dhe rezultateve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Bazuar në Rregulloren e UBT-së (evidenca I.11, Kreu IX, neni 56) dhe Rregulloren e programit të studimit (evidenca I.14) konstatohet se ato përcaktojnë kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve, aftësive profesionale dhe shkencore. Ato janë publike në faqen elektronike të IAL-së. https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve Në ndihmë të këtij procesi vjen edhe Koordinatorin i studentëve i zgjedhur nga ana e departamentit i cili i orienton studentët mbi këto dokumentacione që përmbajnë kontrollin e njohurive.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të	GVJ vëren se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” informon çdo fillim viti

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	akademik studentët në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të cilat evidentohen qartë në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullarët e lëndëve/moduleve (evidencat I.23, I.11, Programet lëndore, Rregullore e UBT-së).								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në programet lëndore (evidenca I.23), testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Të tilla janë, leksione, seminarët, seancat laboratorike, detyra kursi (evidenca III.11, Foto gjatë prezantimit të detyrave të kursit) etj. Në këtë mënyrë studentit i jepet mundësia të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë mësimnxënies.								
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë dhe personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Ato refletohen në programet lëndore (evidenca I.23) dhe janë të parashikuara në Strategjinë e IAL-së (evidenca I.15) dhe Rregulloren e programit (evidenca I.14). Në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit përfshihen edhe studentët duke mundësuar mendimet dhe sugjerimet e tyre.								
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ konstanton se, Statuti i UBT-së (evidenca I.0, Kreu II, neni 6), Rregullorja e UBT-së (evidenca I.11, Keu II, neni 12) Rregullorja e Njesisë Bazë (evidenca I.13, Kreu III, neni 8) si dhe Rregullorja e programit të studimit (evidenca I.14) parashikojnë dhe mundësojnë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. Nëpërmjet orëve të leksioneve, seminareve, orëve laboratorike, detyrave të kursit (evidenca I.23), si dhe e-learning (evidenca III.12, komunikim në google classroom) mundësohet përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e programit. Në këtë mënyrë inkurajohet sensi i autonomisë tek studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzime dhe mbështetje nga personeli akademik dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.								
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të	GVJ vëren se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Kjo evidentohet në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit (evidenca I.23), në Rregulloren e UBT-së (evidenca I.11, Kreu IX, neni 56) dhe Rreguloren e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Departamentit (evidenca I.13, Kreu V, neni 25).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	RVB raporton se IAL ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. Të tilla janë: https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.avhome.do/ https://www.ubt.pitagora.rash.al/login
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin e programit lëndor (evidenca I.23) dhe Rregulloren e UBT-së (evidenca I.11, Kreu IX, neni 56). Si i tillë, GVJ vlerëson, se ai është në përputhje bazën ligjore në fuqi.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në Rregulloren e Njësisë Kryesore (evidenca I.11, Kreu XIV, neni 95), evidentohet se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin që të përmirësohet në të ardhmen. Pas shpalljes së rezultatit të provimit në sistemin elektronik PITAGORA dhe në respektim me ligjin Nr. 48/2012, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, studenti brenda 48 orëve paraqitet para komisionit për të parë provimin dhe për t’u sqaruar në lidhje me pikët dhe vlerësimin përfundimtar.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Programet lëndore (evidenca I.23) përcaktojnë rregulla apo specifika të cilat shmangien dhe nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra kursi. Personeli akademik monitoron studentët gjatë zhvillimit të provimeve dhe kujdeset që gjatë detyrave të kursit të shmangjet mundësia e kopjimit apo plagjiaturës. Personeli akademik dhe studentët respektojnë kodin e etikës (evidenca I.5).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ evidenton se rezultatet e provimeve hidhen në sistemin elektronik brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e IAL-së (evidenca I.11, Kreu IX, neni 65). Vlerësimi bëhet me pikë të cilat konvertohen në notën sipas përcaktimeve në programet lëndore (evidenca I.23).
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ vlerëson se UBT garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit. Ato janë në përputhje me rregullat që përfshihen rregulloren e IAL-së dhe procedurat e vlerësimit (evidenca I.11, Kreu IX, neni 66).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në përputhje me Rregulloren e UBT-së (evidenca I.11, Kreu IX, neni 66), studenti 48 orë pas marrjes së rezultatit të vlerësimit ka të drejtë të paraqesë kërkesë për ankimim. Procedura e ndjekur është transparente sipas rregullave të përfshira në Rregulloren e Njësisë Kryesore.
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se UBT siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Procedurat e vlerësimit dhe ankimimit janë të sanksionuara në</i>

	<i>rregulloret përkatëse (Rregullore e UBT-së).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngrë struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Bazuar në planin mësimor të programit (evidenca I.22) konstantohet se studentit i garantohet thellim i njohurive, zhvillim i aftësive profesionale dhe të veçanta në fushën e nutricionit. Struktura e programit është në përputhje me VKM Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, ndryshuar me VKM Nr. 879, Dt. 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 41 Dt. 24.01.2018” ³ dhe VKM Nr.185 dt. 25.03.2021 ⁴ . Plani mësimor përfshin veprimtaritë mësimore, leksione, seminare, ushtrime, laboratore, studim individual në përputhje me VKM-të e sipërcituara.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Referuar Tabelës 10 ASCAL vërehet se kategoritë e lëndëve integruese dhe plotësuese garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. Të tilla janë informatika dhe statistika (evidenca I.22). Përfshirja e gjuhës së huaj (anglisht) në kurrikulën e programit zhvillon aftësitë e komunikimit dhe ndërveprimit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kurrikula e programit dhe programet lëndore (evidencat I.22, I.23) evidentojnë se kompetencat dhe aftësitë që studenti fiton, analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të lëndës. Programet lëndore përfshijnë gjithashtu, elementët e kontrollit të vazhduar si diskutime në seminare, kolekiume, detyra kursi dhe provimi përfundimtar. Në këtë mënyrë, personeli akademik i vë në dukje çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur	Referuar planit mësimor dhe programeve lëndore (evidencat I.22, I.23), GVJ vëren se procesi i mësimdhënies realizohet mbi bazë kompetencash që u jep studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në orët laboratorike dhe praktikat profesionale. Takimet në mbledhjet e departamentit evidentojnë se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup për interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve apo çështjeve të caktuara duke krijuar një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore e shkencore (evidenca III.26, Proces verbal mbledhje deprtamenti). Personeli akademik mbështet gjithashtu, diskutimet në grup të studentëve p.sh. gjatë orëve të seminarit, diskutimeve të detyrave të kursit dhe u

³ https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_nr_41_date_24_1_2018_9fab9164a8.pdf

<https://fshn.edu.al/Info/vkm/notifications/nr-41-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte>



https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM_Nr_879_date_18_12_2019_46b1a0c982.pdf

⁴ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/6.-vendim-2021-03-25-185.pdf>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	mundëson atyre pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe mobilitete (evidenca III.27, Projekt ERASMUS). <i>Rekomandohet përfshirje më e gjerë e studentëve të Programit të Studimit në projekte kërkimore.</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Evidenca III.25 (Leksione të hapura) është tregues se personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit. Tematika e orëve të hapura është e gjerë dhe me interes për studentët dhe publikun.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UBT/Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ka ngritur struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet/programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Referuar Rregullores së UBT-së (evidenca I.11, Kreu IV, nenet 28, 29) dhe Rregullores së programit (evidenca I.14) vërehet se IAL ka hatuar dhe përcaktuar rregullat e nevojshme për provimin e diplomës ose punimin e diplomës. Procedurat për detyrimet përmbyllëse të studentit bëhen publike nga Njësia Kryesore. https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ eidenton se personeli akademik asiston studentët, duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të realizimit të provimit ose punimit të diplomës (evidenca I.14, Rregullore e programit). Bazuar në programin e provimit të diplomës konstantohet se personeli akademik përgjigjës harton programin e provimit. Provimi bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë tre viteve të studimit. Programi i provimit të diplomës bëhet publik për studentët të paktën dy muaj përpara provimit të diplomës (evidenca I.11, Kreu IV, nenet 28, 29).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ konstanton se Njësia Bazë, ngre Komisionin e Diplomimit, kryetari i të cilit miratohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me tituj e grada shkencore (evidenca III.29, Njoftim i Komisionit të Diplomimit). Titullarët e lëndëve karakterizuese që bëjnë pjesë në programin e studimit, hartojnë pyetjet formuese (listë me rreth 100 pyetje) të cilat vendosen në dispozicion studentit për orientim (evidenca I.14, Rregullore e programit).
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe	GVJ vëren se për arsye të numrit të madh të studentëve të studimit të ciklit të parë, për të finalizuar detyrimet përmbyllëse studentët paraqiten

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>para komisionit të diplomimit për të dhënë njohuritë e tyre nëpërmjet provimit të diplomës. Rregullat janë përcaktuar sipas rregulloreve përkatëse të përmendura në kriteret 1-3 të këtij standardi.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Referuar analizave/raporteve vjetore të Njesisë Kryesore (evidencat I.25-I.28) konstantohet se studentët asistohet për kryerjen e matjeve, analizave, testeve për të zhvilluar pjesën eksperimentale të punimit të diplomës sipas temave dhe fushës së studimit. Njësia Kryesore dhe ajo Bazë garantojnë zhvillimin e punimit të temës së diplomës edhe jashtë institucionit (evidenca I.33, I.34, Marrëveshje bashkëpunimi).</p>			
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ vëren se në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Për studentët të cilët mbyllin detyrimet përmblyëse me provim final, vlerësimi i studentit është një mesatare e thjeshtë aritmetike të pesë anëtarëve të komisionit. Për studentët të cilët paraqesin punim diplome, komisioni përkatës bën vlerësimin bazuar në punimin e diplomës, prezantimin dhe vlerësimin e udhëheqësit. Sistemi i notës është nga 1 në 10 dhe nga 5 në 10 është note kaluese (evidenca I.12, Rregullore e Njesisë Kryesore).</p>			
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UBT-së (evidenca I.11, Kreu XII, neni 87) konstantohet se studenti ka të drejtë të pajiset me një kopje të plotë të programit të studimit të zhvilluar.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konstanton se bazuar në Rregulloren e UBT-së (evidenca I.11, Kreu VII, neni 44) IAL/sekretaria mësimore mban në formë të shkruar dhe elektronike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar (bazë) të studentëve • Regjistrin e arritjeve akademike • Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave 			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se UBT ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit të përcaktuara në Rregulloren e IAL dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------------

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në të dhënat për stafin akademik dhe ndihmës akademik të DSHUB (Evidenca I.24, Tabela 2 ASCAL), CV-të e stafit (Evidenca II16), dhe Rregulloren e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Evidenca I.3), gjykojmë se përmbushen kërkesat ligjore në fuqi (Ligji Nr. 80/2015; Udhëzimi nr. 37 i dt. 04.12.2018).</p> <p>Nga këto evidenca konstantohet se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik (Tabela 2 ASCAL). Gjithashtu bazuar në kualifikimet e tyre personeli akademik dhe ndihmës akademik përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për drejtimin e programit dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e brendshme të UBT, Kreu IX, nenet 24,51,56,57 (Evidenca I.11) ngarkesa mesimore për programin e studimit mbulohet nga stafi PAE sipas parashikimeve të Ligjit për IAL në fuqi, rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse.</p> <p>Referuar evidencës I.11 (Rregullore e UBT), vëreshet se Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>Referuar udhëzimit Nr. 1, Dt. 14.1.2020 të MAS, personeli akademik me kohë të plotë i programit të studimit mbulon jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore të programi studimit (Tabela 4 ASCAL).</p> <p>https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në Evidencat Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave (Evidenca I.3) dhe Rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ të UBT (Evidenca I.9), dhe Model Kontrate punësimi (Evidenca IV.6) ky kriter plotësohet.</p> <p>Bazuar në këto evidenca konstantohet se UBT garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje</p>	<p>Bazuar në Evidencat Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave (Evidenca I.3) dhe Rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmes-akademik dhe administrativ të UBT (Evidenca I.9), dhe në evidencat II.7 Planifikim i shpërndarjes së ngarkesës mësimore në DSHUB, IV.1 Kopje e kërkesës zyrtare për pedagog të ftuar, IV.2 Kopje ekstrakti shpallje vendi pune në UBT, ky kriter</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	plotësohet. Për sa më sipër, konstantohet se IAL ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara. Ato garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	UBT siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës-akademik në përputhje me nevojat e programit, bazuar në Statutin e UBT, kreu 6 (Evidenca I.0), Rregulloren e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave (Evidenca I.3), Rregulloren për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ të UBT (Evidenca I.9).
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Referuar evidencave I.3 Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, I.12 Rregullore e Njesisë Kryesore FBU, Neni 103, dhe II.7 Planifikimi i shpërndarjes së Ngarkesës Mësimore DSHUB, GVJ vlerëson se IAL mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bazuar në evidencat II.7 Planifikimi i shpërndarjes së ngarkesës mësimore në DSHUB, I.11 Rregullore e brendshme e IAL/UBT për studimet universitare, Kreu IV, neni 20; I.13 Rregullore e njesisë bazë/DSHUB, kreu VI, neni 38; institucioni organizon dhe drejton praktikën profesionale dhe punimin e diplomës së studentëve të BSH në SHUU. Gjithashtu, falë marrëveshjeve me institucione dhe biznese (Evidencat I.33; I.34) mundësohet kryerja e praktikave dhe punimeve të diplomës pranë tyre dhe nën instruktimin e duhur.
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Falë marrëveshjeve me institucione dhe biznese (Evidencat I.33; I.34) mundësohet kryerja e praktikave dhe punimeve të diplomës pranë tyre dhe nën instruktimin e duhur (evidenca IV.13, Udhëzues i praktikës profesionale).
Konkluzione	<i>Gjetjet e GVJ janë që personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Në mbështetje të këtij kriteri, UBT ka ofruar dokumentacion mbi studentët e regjistruar në DSHUB (Ev. II.14), Infrastrukturën dhe Mjediset në funksion të mësimin në UBT (Evidenca III.8), Planimetrinë e godinës së njësisë kryesore të FBU (Evidenca IV.7), si edhe Raportime për veprimtarinë mësimore-kërkimore në vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 (Evidenca I.25, I.27, I.28) në të cilat përshkruhen problematika dhe tregohet ecuria e menaxhimit të tyre nga viti në vit. Analiza mësimore shkencore 2019-2020 UBT (pika 3.4) sipas të cilit për vitin akademik 2019-2020 kanë qenë në përdorim të FEA-s 53 salla mësimi, nga të cilat 16 salla leksionesh, 7 prej tyre janë me kapacitet nga 52 deri në 79 vende dhe 9 salla janë me kapacitet mbi 150 vende, ndërkohë që numri maksimal i studentëve në ciklin Bachelor dhe Master është 120-150. Bazuar në sa më sipër kriteri 1 plotësohet.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në mbështetje të kriterit të dytë institucioni ka ofruar dokumentat si vijojnë: II.9.1. Lista e inventareve të mjeteve laboratorike-didaktike, ku detajohen gjithë infrastruktura laboratorike; III.8 Infrastruktura në aspektin mësimor në FBU, III.11 Foto dokument, III.15 Inss projects library online, përmes të cilave mjediset rezultojnë të paisur me aparatura bashkëkohore në shërbim të moduleve dhe realizimit të aspekteve mësimore teorike dhe laboratorike.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në mbështetje të kriterit të tretë institucioni ka ofruar dokumentat si vijojnë: II.9.1. Lista e inventareve të mjeteve laboratorike-didaktike, ku detajohen gjithë infrastruktura laboratorike; III.8 Infrastruktura në aspektin mësimor në FBU, III.11 Foto dokument, III.15 Inss projects library online, përmes të cilave mjediset rezultojnë të paisur me aparatura bashkëkohore në shërbim të moduleve dhe realizimit të aspekteve mësimore teorike dhe laboratorike. Gjithashtu, paraqiten Evidenca I.23 Syllabuset e moduleve të programit BSc. në SHUU, dhe Evidenca III.14 Investime në kuadër të projektit ERASMUS/STEPS 2019-2023, me anë të të cilave sqarohet përputhshmëria e kërkesave të programit me gjendjen aktuale.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në RVB, në kuadër të projektit NETCHEM, në 2018 pranë FBU u instalua një laborator i teknologjisë së informacionit, i cili do të ri-instalohet në godinën e re që do të përfundojë në 2023.
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UBT vë në dispozicion mjedise mësimore dhe</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion syllabuset në të cilat pasqyrohet literatura bazë dhe ajo e rekomanduar për studentët (Evidenca I.23), Listën e materialeve didaktike për programin BSH në SHUU (Evidenca III.17), materiale të shkruara të vëna në dispozicion në site-in e e pedagogut (Evidenca III.18), adresën e platformës Springshare LNSS (Evidenca III.15), si edhe katalogun online të Bibliotekës së UBT (Evidenca III.16).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Në mbështetje të këtij kriteri janë syllabuset në të cilat pasqyrohet literatura bazë dhe ajo e rekomanduar e përditësuar për studentët (Evidenca I.23), materiale të përditësuara të shkruara të vëna në dispozicion në site-in e e pedagogut (Ev. III.18), adresën e platformës Springshare LNSS (Evidenca III.15), katalogun online të Bibliotekës së UBT (Evidenca III.16) dhe Platforma online U-library (Evidenca III.19).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UBT në shërbim të studenteve ka tre biblioteka, me tre salla leximi, me 6 veta personel me vëndndodhje në Bibliotekën qendrore, në Godinën e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe në Fakultetin e Mjeksisë Veterinare. Të dhëna mbi librarinë online jepen në Evidenca III.15 (Inss projects library online); Të dhëna mbi gjendjen fizike, titujt dhe burimet online ofrohen në Evidenca III.13 (Biblioteka “M. Permeti” në IAL/UBT raport).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Të dhëna mbi librarinë online jepen në Evidenca III.15 (Inss projects library online); Të dhëna mbi gjendjen fizike, titujt dhe burimet online ofrohen në Evidenca III.13, IV.14 (Biblioteka “M. Permeti” në IAL/UBT raport dhe ndarja e literaturës sipas fushave). Referuar evidencave të sipërcituara GVJ konstanton se biblioteka e UBT-së është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës dhe specifikës së programit të studimit të ofruar nga Njësia Bazë.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UBT ofron akses pa pagesë për përdorimin e bibliotekave online (Evidenca III.20 Manuali i aksesit në bibliotekën online. RVB). Gjithashtu ofrohet informacion mbi Evidenca III.15 (Inss projects library online); Librarinë digjitale https://www.ulibrary.rash.al ; dhe aksesin e studentëve dhe stafit në libraritë www.cobis.net ; www.eifl.net ; www.akad.edu.al/era ;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Institucioni ka ofruar informacion mbi kapacitetet e bibliotekës me tre godina në shërbim të saj në Evidenca III.13 (Biblioteka “M. Permeti” në IAL/UBT raport); ka ofruar dokumentin III.8 Infrastruktura në aspektin mësimor në FBU; atë III.11 Foto dokument; dhe III.15 Inss projects library online, përmes të cilave mjediset rezultojnë të paisur me aparatura bashkëkohore në shërbim të moduleve dhe realizimit të aspekteve mësimore teorike dhe laboratorike.</p>			
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Bazuar në RVB oraret e bibliotekës janë 08:00-16:00, dhe mjediset në dispozicion të studentëve e kapaciteti e rendisin ndër më të medhatë në vend (https://lnss-albania.libguides.com/c.php?g=667392). Informacioni mbi funksionimin, oraret etj. është publik në faqen web të UBT.</p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka ofruar Evidencën III.13 (Biblioteka “M. Permeti” në IAL/UBT raport) me anë të të cilit raportohet gjendja e saj. Gjithashtu, ofrohet Evidenca III.7 Raport i Analizës Mësimore FBU ku përshkruhet sesi evidentohet gjendja, problematikat, përditësimi, shkalla e shfrytëzimit të fondit të bibliotekës, etj.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstanton se programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimdhënies, (bibliotekën dhe mjediset e posaçme).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Për menaxhimin e programit Bsc. në SHUU, Universiteti Bujqësor i Tiranës ka një sistem menaxhimi të tipit PITAGORA, falë të cilit i gjithë informacioni nga regjistrimi deri në diplomim të studentëve është i siguruar. Përveç kësaj, ky sistem shërben për njoftimin e studentëve për datat e provimeve, regjistrimin për provime, dhe vlerësimet e marra. Sekretaria e UBT mban regjistra të studentëve nga fillimi në përfundim të studimeve (RVB). Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka depozituar edhe evidencë si I.12 Rregullorja e brendshme FBU; I.13 Rregullore e njësisë bazë DSHUUB; I.14 Rregullore e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Programit të studimit BSH ne SHUU, në të cilat trajtohet me kujdes mënyra e menaxhimit të informacioneve mbi studentët, II.14 Studentë të regjistruar në DSHUB dhe I.45 Lista e studentëve të BSHUU në kuadër të zhvillimit të praktikës mësimore.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administro informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Për menaxhimin e programit BSc në SHHU, Universiteti Bujqësor i Tiranës ka një sistem menaxhimi të tipit PITAGORA, i cili përmban gjithë informacionin mbi veprimtarinë e stafit akademik, ndihmësakademik dhe administrative, dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Në informacionin e depozituar nga institucioni gjenden gjithashtu Evidenca I.3 Rregullore e DMBNJP/UBT ku sqarohet mënyra e menaxhimit të të dhenave; I.25 Analiza e punës mësimore FBU 2019-2020; I.26 Analiza e punës kërkimore FBU 2019-2020; I.27 Raport për veprimtarinë mësimore-kërkimore FBU 2020-2021; I.28 Raport për veprimtarinë mësimore-kërkimore FBU 2021-2022; I.37 Mobilititeti i stafit akademik i ardhur në FBU; I.38 Mobiliteti i stafit FBU 2016-2021; II.16 CV staff akademik; 16.1/16.2/16.3 CV Stafit, me anë të të cilave evidentohet administrimi i dokumentacionit, aktivitetit të stafit në nivele të ndryshme nga njësia bazë deri në njësinë kryesore.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Falë sistemit PITAGORA, i gjithë informacioni nga regjistrimi deri në diplomim të studentëve është i siguruar. Përveç kësaj, ky sistem shërben për njoftimin e studentëve për datat e provimeve, regjistrimin për provime, dhe vlerësimet e marra.</p> <p>Gjithashtu, akses mbi të dhenat ofrohet përmes:</p> <p>www.esse.gov.al www.sekretariatUBT www.ubt.pitagora.rash.al/login</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit PITAGORA ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit midis studentëve dhe stafit.</p> <p>www.esse.gov.al www.sekretariatUBT www.ubt.pitagora.rash.al/login</p> <p>Gjithashtu, çdo input informacioni në sistem shoqërohet me shkresa sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UBT (Evidenca III.12 Shembuj komunikimi në platforma online me studentët).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi PITAGORA është sistem online që mundëson aksesin e dëshiruar të informacionit në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> <p>www.sekretariatUBT www.ubt.pitagora.rash.al/login</p> <p>Gjithashtu, çdo input informacioni në sistem shoqërohet me shkresa sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UBT (Evidenca III.12 Shembuj komunikimi në platforma online me studentët).</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është</p>	<p>Bazuar në RVB, UBT në përmbushje të detyrimeve të Ligjit Nr. 119/2014, Neni 4 Mbi të drejtën e informimit, publikon në website-in zyrtar informacione mbi programet mësimore, stafin, veprimtaritë, në të paktën dy gjuhë njëra prej të cilave shqip (Evidenca IV.8).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

gjuha shqipe.	www.UBT.edu.al			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UBT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në mbështetje të këtij kriteri insitucioni ka ofruar Evidenca IV.10 Planifikim financiar në njësinë bazë 2022-2023, ku tregohet mënyra e planifikimit për vitin akademik respektiv, dhe bazën ligjore për planifikimin (Evidenca IV.9 VKM Nr. 368 e dt. 22.07.2015). Njëherësh, në RVB sqarohet se planifikimi financiar bëhet çdo vit në nivel fakulteti dhe si evidencë paraqitet IV.12 Buxheti i miratuar në UBT 2022.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Bazuar në Evidencën IV.12 Detajim buxheti i miratuar për UBT 2022 ky kriter plotësohet. Referuar evidencës IV.12, GVJ vlerëson se buxheti i UBT përfshin planin e financimit të njësisë bazë e cila është përgjegjëse për programin e studimit. Ky buxhet përfshin financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor-kërkimor, shpenzimet për bibliotekën, pasurimin e saj me literaturë, kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të programit si dhe projekte të ndryshme.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UBT bazuar në RVB, kryen audit të brendshëm të përvitshëm me anë të njësisë së brendshme të auditit. Raporti financiar përmban të dhëna mbi të ardhurat nga rregjistrimet dhe kontributet e tjera, dhe reflekton ndarjen e shpenzimeve në kategori, si pagesa, qera, shpenzime administrative, shpenzime për kërkimin shkencor, etj. sipas legjislacionit në fuqi (Evidenca IV.11 Dokumentim /auditim/raportim/www.edu.al).
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Mënyra e hartimit të buxheteve të përvitshme në UBT kryhet në bashkëpunim me departamentet dhe bazuar në kërkesat e tyre. Në mbështetje të këtij kriteri insitucioni ka ofruar Evidenca IV.12 Projekt-buxheti UBT 2022, ku tregohet mënyra e planifikimit për vitin respektiv.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare	Planifikimi Financiar vjetor i sqaruar ne Evidenca 28 IV.12 Projekt-buxheti UBT 2022 është përdorur për të treguar sesi UBT punon për qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit përmes kategorive të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Këtij dokumenti i referohet edhe RVB.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UBT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësues-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Politikat dhe procedurat e ndjekura nga UBT prej regjistrimit të studentëve deri në diplomim përshkruhen në Rregulloren e UBT (Evidenca I.11), në Rregulloren e FBU (Evidenca I.12) dhe në Rregulloren e Programit të studimit Bsc. në SHUU (Evidenca II.6). Për implementimin e politikave dhe procedurave shërben një strukturë e konsoliduar e përbërë nga Dega e Zhvillimit të Kurrikulës, Karrierës dhe Ndhmës Institucionale, dhe Dega e Informimit dhe Transferimit të Teknologjisë. Këto struktura adresojnë dhe administrojnë problematika të procesit të të mesuarit dhe zhvillimit të karrierës të studentëve të UBT nga hyrja deri në diplomim. Gjithashtu, Qendra e Karrierës për studentët komunikon me studentët dhe koordinon veprimet me sekretariatet e departamenteve, dhe administratorin e universitetit duke zgjidhur një mori problematikash (Evidenca V.10).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Kriteret e pranimit në Programin BSc. në SHUU hartohen në përputhje me Ligjin 80/2015, Neni 74, dhe miratohen nga rektorati i UBT dhe Senati Akademik. Ndjekja e zbatimit të dokumentave të miratuara kryhet nga Zv Rektori për Edukimin, Zyra e Zhvillimit të Karrierës, Zyra për Studentët dhe Studimet. Dokumenta si Rregullore e FBU (Evidenca I.12); Rregullore e UBT (Evidenca I.11); Evidenca V.1 (Udhëzim mbi pranimet në universitetet publike); Evidenca V.2 (Urdhër i përbashkët Nr. 1 dt. 07.06.2019); janë ndër dokumentat rregullatore të procesit. Pas regjistrimit në sekretarinë e fakultetit studentët plotësojnë edhe regjistrimin në sistemin elektronik PITAGORA https://www.ubt.pitagora.rash.al/login , i cili ju mundëson të informohen mbi datat/oraret/ vlerësimet, etj. në vazhdim të studimeve.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Hartimi dhe miratimi i kriterëve të pranimit në programin BSc. në SHUU bëhet çdo vit akademik në përputhje me Evidenca I.12 Rregullorja e studimeve në FBU dhe Evidenca I.11 Rregullorja UBT, të cilat janë në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në fuqi dhe VKM 295, dt.10.05.2019. Programet, kuotat dhe kriteret respektive publikohen në portalin U-Albania dhe website e UBT. Kriteret e pranimit në programin BSc. në SHUU bëhen publike nga fakulteti në website-in: https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/R3.26FBU-Shkenca-e-Ushqimit-dhe-te-Utrehrit.pdf Gjithashtu, në website-in e UB jepet informacion mbi kuotat për çdo program studimi përfshirë kategorinë e studentëve të huaj. (https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/Kuotat-Cikli-i-pare-dhe-i-dyte-UBT.pdf)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së	Procedura për hartimin e kriterëve të pranimit në programin BSc. në SHUU fillon në njësinë bazë, më pas miratohen nga Senati i UBT dhe i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>përcillen MAS. Kriteret e pranimit në programin BSc. në SHUU bëhen publike nga fakulteti në website-in: https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/R3.26FBU-Shkenca-e-Ushqimit-dhe-te-Utrehrit.pdf Rregullorja e Programit të studimit në BSc. në SHUU (Evidenca I.14), Rregullorja e UBT, kreu X, neni 69 (Evidenca I.11), dhe Rregullorja e FBU, kreu X (Evidenca I.12), rregullojnë transferimin dhe njohjen e studimeve të mëparshme dhe/ose të pjesshme. Studentët dhe të interesuarit mund të marrin informacion mbi vlerësimet gjatë gjithë periudhës së studimeve në sistemin PITAGORA duke përdorur adresat personale (evidenca III.21. Manuali i regjistrimit në sistemin online PITAGORA).</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret e pranimit në programin BSc. në SHUU bëhen publike nga fakulteti në website-in: https://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2022/10/R3.26FBU-Shkenca-e-Ushqimit-dhe-te-Utrehrit.pdf Njëherësh Qendra e Karrierës, Alumnit dhe Aktiviteteve Kulturorë Sportive organizojnë evente informuese (Evidenca V.5 Fletëpalosja e DSHUB/FBU; Evidenca V.6 Promocioni i UBT-Infomimi i maturantëve; Evidenca V.7 Open Day).</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Pjesë e procedurave për hartimin dhe publikimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit të UBT është edhe përcaktimi i përvitshëm i kuotave për kategoritë aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara (Evidenca I.11 Rregullore e brendshme UBT, kreu 4, neni 22).</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Pjesë e procedurave për hartimin dhe publikimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit të UBT është edhe përcaktimi i përvitshëm i kuotave për kategoritë aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara dhe kandidatëve nga shtete të tjera (Evidenca I.11 Rregullore e brendshme UBT, kreu 4, neni 22).</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UBT harton politika të ndihmës përmes bursave për shtresat në nevojë në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015 i datës 22.07.2015, VKM Nr. 784 i datës 21.12.2016, VKM Nr. 779 i datës 26.12.2018, VKM Nr. 269 i datës 29.03.2017, dhe VKM Nr. 780 e datës 26.12.2018. Gjithashtu, referuar statutit të UBT (evidenca I.0), rezultojnë se UBT harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë si dhe politika për të rritur cilësinë e pranimit në programin e studimit me përparësi për IAL dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstanton se UBT harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studenteve gjatë gjithë periudhës së studimit, sqarohen nga Rregullorja e UBT (Evidenca I.11), Rregullorja e FBU (Evidenca I.12) dhe Rregullorja e Programit BSc. në SHUU (Evidenca I.14). Gjithashtu në mbështetje të sa më sipër institucioni ka ofruar Evidenca V.8 Komunikim përmes rrjeteve sociale, dhe Evidenca IV.8 Dosja e faqes web zyrtare.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve janë të përcaktuara në rregulloret e njëjësive bazë, të cilat janë hartuar në përputhje me Ligjin në fuqi për IAL si Rregullorja e FBU (Evidenca I.12), Rregullorja e DZHKKVI (Evidenca I.11, kreu 14, neni 95, pika 9). Njoftimi i studentëve për mundësitë e transferimeve dhe llogaritjen e krediteve të marra kryhet përmes Zyrës së Studentëve dhe Studimeve, dhe Zyrës së Karrierës (Evidenca I.11, kreu 14, neni 95, pika 9). ZKS ka rol të posaçëm në dokumentimin e procesit (Evidenca V.9 UBT-Kuota 2020-2021).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka ofruar evidencat I.11 Rregullore e UBT, kap X, nenet 67-75; Evidenca I.11 Rregullore e UBT, kap IV, neni 19; Evidenca I.14 Rregullore e programit të studimit BSc. në SHUU. Njëherësh njoftimi i studentëve mbi vlerësimet kryhet me anë të sistemit online PITAGORA.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ka ofruar evidencat I.11 Rregullore e UBT, kap X, nenet 67-75; Evidenca I.11 Rregullore e UBT, kap IV, neni 19; Ev. I.14 Rregullore e programit të studimit BSc. në SHUU. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit me anë të sistemit online PITAGORA.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UBT përmes Zyrës së Karrierës në bashkepunim me departamentet publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Në mbështetje të sa më sipër janë dokumentuar Evidenca I.31 Raport statistikor nga zyra e karrierës për gjurmimin dhe punësimin e studentëve të diplomuar; Evidenca V.11 Panairë në UBT; Evidenca V 10. Qendra e Karrierës dhe Alumni.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstanton se UBT vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin Bachelor në Shkencat e Ushqyerit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Në mbështetje të këtij kriteri institucioni ofron evidencat V.5 Fletëpalosje e DSHUB, Fletëpalosje FBU; faqes web të UBT, dhe platformave sociale facebook/instagram. Pranë njësive bazë edhe në website-in e UBT (Evidenca V.8) gjenden informacione të detajuara mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit të cilat përdoren përpara fillimit të çdo viti akademik në fushata për informimin e studentëve.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentëve që rregjistrohen në BSc. në SHUU ju vihen në dispozicion dokumentat V.5 Fletëpalosje e DSHUB, Fletëpalosje FBU; Guida e studimeve në FBU. Pranë njësive bazë edhe në website-in e UBT (Evidenca V.8) gjenden informacione të detajuara për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Qendrës për Karrierën dhe Alumni (Evidenca V.10), një raport të gjurmimit të studentëve (Evidencat I.30 dhe I.31) pas diplomimit. Njëherësh kjo zyrë ndjek me kujdes dhe orienton studentët drejt karrierës bazuar në Listen e marreveshjeve të UBT me biznese (Evidenca I.33). Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë ka hartuar një dokument mbi Studimin e Tregut të punës për të diplomuarit në programin BSc. në SHUU (Evidenca II.1). Marrëveshje të UBT me biznese-institucione është gjithashtu pjesë e paketës së dokumentave të ofruara nga institucioni (Evidenca I.33).
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni mbi zhvillimin, organizimin, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet ju ofrohet studentëve nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta në auditor, fletëpalosjeve etj. (Evidenca V.5 Fletëpalosje e DSHUB, Fletëpalosje FBU; Guida e studimeve në FBU). Pranë njësive bazë edhe në website-in e UBT (Evidenca V.8) gjenden informacione të detajuara për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese si dhe Bibliotekën Mentor Përmeti e kapacitetet e saj online (Evidenca III.13).
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni paraqitjen e kurrikulës në WEB site, si edhe sistemi i brendshëm i menaxhimit PITAGORA (Evidenca III.12 Shembuj të komunikimit përmes platformave online; Evidenca III.13 Biblioteka Mentor Përmeti; Evidenca III.15 Inss.projects-library online; Ev III.19 Platforma online U-library; Ev III.20 Manuali i aksesit-ulibri_rashal; Ev III.21 Manuali PITAGORA)
Konkluzione	<i>GVJ konstanton se UBT vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren e DZHKKVI, neni 32, fq. 26, (Evidenca V.10) UBT ka struktura për ruajtjen e të dhënave të studentëve dhe përpunimin statistikor të tyre, si Arkivi Qendror i UBT, Zyra e Studentëve dhe Studimeve. Gjithashtu, në DSHUB ruhen të dhëna statistikore mbi rregjistrimet, numrin e diplomanteve, çrregjistrimet, numrin e atyre që nuk përfundojnë studimet për arsye të ndryshme, etj. (Evidenca II.14 Tabela përmbledhese e studentëve të rregjistruar në BSH në SHUU 2021-2022).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Bazuar në Rregulloren e DZHKKVI, neni 32, fq. 26, (Evidenca V.10) UBT ka struktura për ruajtjen e të dhënave të studentëve dhe përpunimin statistikor të tyre, si Arkivi Qendror i UBT, Zyra e Studentëve dhe Studimeve. Gjithashtu, në DSHUB ruhen të dhëna statistikore mbi rregjistrimet, numrin e diplomanteve, çrregjistrimet, numrin e atyre që nuk përfundojnë studimet për arsye të ndryshme, etj. (Evidenca II.14 Tabela përmbledhese e studentëve të rregjistruar në BSH në SHUU 2021-2022).
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga informacioni i ofruar rezultojnë se sistemi i brendshëm online PITAGORA është vendi i menaxhimit të të dhënave të studentëve. Si i tillë është lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar. Kriteri plotësohet bazuar në (Evidencën V.10, neni 12, fq. 10).
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Kriteri plotësohet bazuar në (Evidencën V.10. Rregullorja e DZHKKVI, neni 12, fq. 10). Referruar (Evidencës V.10), GVJ vlerëson se UBT, mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.). UBT vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre	Nga raportet analitike të përvitshme të departamentit DSHBU (Evidenca RVB) përgatiten raportet në nivel fakulteti dhe universiteti (Evidenca III.7 Raport Vjetor i analizës mësimore në UBT për 2020-2021; Evidenca I.27 Raport mësimor-kërkimor FBU 2020-2021; Evidenca I.28/29 Raport Mësimor-kërkimor FBU 2021-2022 dhe Evidenca I.31 Raport statistikor nga zyra e karrierës për gjurmim dhe punësim të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

reguesve.	studenteve të diplomuar në FBU ndër vite).			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UBT mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni rezultojnë se UBT parashikon në Statutin e tij (Evidenca I.0, Kreu VI, neni 52, pika 1 përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese). Po bazuar në (Evidencat I.0 dhe III.10 Këshilli Studentor i UBT) studentët kanë përfaqësuesit e tyre në strukturat e këshillave studentorë.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Statuti i UBT (neni 37 Evidenca I.0) ka sanksionuar të drejtën për përfshirje të studentëve në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësim të procesit akademik. Efektivitetin e këtij angazhimi studentor e dëshmojnë dokumentat si Evidenca III.2 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor UBT 2018-2019; Evidenca III.3 Ekstrakt tip anketimi për student aplikuar në DSHUB; Evidenca III.27 TTO4FOOD-Studentë-ide inovative; Evidenca V.7 Aktivitete Open day.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni rezultojnë se UBT parashikon në Statutin e tij (Evidenca I.0) përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese. Evidenca III.2 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor UBT 2018-2019; Evidenca III.3 Ekstrakt tip anketimi për student aplikuar në DSHUB; Evidenca III.27 TTO4FOOD-Studentë-ide inovative; Pjesëmarrja e studentëve në këto organizime i shërben përfshirjes së tyre në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësive/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në Statutin e UBT, Nenin 49 dhe 50 (Evidenca I.0, Të drejtat dhe detyrimet e studentëve) studentët e BSH në SHUU kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe vlerësimet e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit. Evidenca III.2 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor UBT 2018-2019; Evidenca III.3 Ekstrakt tip anketimi për student aplikuar në DSHUB janë rezultate të ushtrimit të kësaj të drejte.
Konkluzione	GVJ konstanton se UBT përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Bazuar në Evidencën V.10 Qendra e Karrierës dhe Alumni e UBT ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në mbështetje të parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore. Po në shërbim të informimit të studentëve janë Zyra e Studimeve dhe Studentëve (Evidenca III.22), informacioni i plotë mbi funksionimin e të cilave jepet në web e UBT.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Bazuar në Evidenca V.10 Qendra e Karrierës dhe Alumni e UBT, UBT ka një sistem të posaçëm në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në mbështetje të parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore. Po në shërbim të informimit, këshillimit, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, janë koordinatori i FBU për studentët, sekretaria e DSHBU, Sektori i kurrikulave dhe shërbimit ndaj studentëve (Evidenca RVB).
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Bazuar në Evidencën V.10 Qendra e Karrierës dhe Alumni e UBT dhe në Rregulloren e saj dhe informacionin e ofruar ne website-in e UBT (https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve ; https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni ; etj) ky kriter plotësohet. Për sa më sipër, GVJ vlerëson se UBT u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Konstantohet gjithashtu, se Zyra e Karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike. Ajo u ofron informacion dhe orientim të posaçëm studentëve, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Bazuar në Evidencën V.10 Qendra e Karrierës dhe Alumni e UBT, Evidenca I.31 Statistikë-ZK; Gjurmimi i punësimit të studenteve; Evidenca I.30 Gjurmimi i studentëve në UBT, dhe informacionit në website-in e UBT (https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve ; https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni ; etj) ky kriter plotësohet. Referuar evidencave të sipërcituara, GVJ konstanton se Zyra e Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	studimi. Këto të dhëna vihen në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse të UBT-së.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UBT ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar, UBT ka pjesë të Planit të tij Strategjik (Evidenca I.15) përgatitjen e udhëzuesve për përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. Kjo materializohet në Evidencën III.1 (Udhëzues për zhvillimin e mësimin në distancë), Evidencën III.1.1 (Rregullore e zhvillimit të provimeve online UBT); Evidencën III.12 (Shembuj të komunikimit nëpërmjet platformave online).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	UBT ka zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik të përcaktuara në Statutin e institucionit (Evidenca I.0). Në mbështetje të sa më sipër, UBT ka paraqitur Evidencën I.4 Rregullore e Drejtorisë së vlerësimit të brendshëm dhe sigurimit të cilësisë në IAL/UBT, si njësi përgjegjëse; Evidencën III.2 Raport rezultatet e pyetësorit për student; Evidencën III.2.1 Raport mbi rezultatet e anketimit Qershor 2017; Evidencën III.3 Ekstrakt tip anketimi për studentët në DSHUB si prova të mekanizmave të monitorimit; dhe Evidencën III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor; Evidencën III.2 Raport mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve IAL/UBT; Evidencën III.7 Raport vjetor i analizës UBT 2020-2021 si prova të vlerësimit periodik.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në mbështetje të kriterit institucioni ka ofruar Evidencën III.2 Raport rezultatet e pyetësorit për student; Evidencën III.2.1 Raport mbi rezultatet e anketimit Qershor 2017; Evidencën III.3 Ekstrakt tip anketimi për studentët në DSHUB si prova të mekanizmave të monitorimit; Evidencën III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor; dhe Evidencën III.2 Raport mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve IAL/UBT. Gjithashtu, ofrohet Evidenca I.5 Kodi i etikës në UBT në të cilin trajtohet mundësia për adresimin dhe trajtimin e ankesave nga studentët.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. Në mbështetje të sa më sipër ofrohen Evidenca III.5 (Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor); Evidenca III.2 (Raport mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve IAL/UBT); Evidenca I.25 (Raport i analizës mësimore FBU 2019-2020, seksioni anketimet/pyetësorët).
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni në mbështetje të këtij kriteri ka hartuar Udhëzimin Nr. 5, të dt. 19.02.2018 “Mbi përcaktimin e elementeve të raportimit vjetor”, etj (Evidenca III.6). Njëherësh vlerësimi i rezultateve të marra kryhet përmes raportimeve në nivel njësie bazë, FBU dhe Universiteti (Evidenca I.29 Analiza e punës mësimore-kërkimore DSHUB 2021-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	2022; Evidenca III.7 Raport Vjetor i Analizës mësimore UBT 2020-2021, në të cilin ndër të tjera promovimi i shembujve të mirë bëhet edhe përmes mbështetjes financiare; Evidenca III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor.			
Konkluzione	<i>GVJ konstanton se UBT ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Evidencat I.4 Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë në IAL/UBT; Evidenca I.0 Statuti i UBT, kreu II, neni 5, 56; Evidenca I.11 Rregullore e brendshme e IAL/UBT për studimet universitare, kreu XIII, neni 91; Evidenca I.15 Plan Strategjia e Zhvillimit të IAL/UBT, si edhe informacionin e ofruar në website-in e UBT (https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve ; https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni) sqarohet se UBT ka politika, struktura dhe për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në Evidencën I.0 (Strategjia e UBT), dhe Evidencën I.4 (Rregullore e DVBS/UBT), institucioni ka një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Njëherësh, bazuar në Evidencën III.2 Raport mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve IAL/UBT; Evidencën III.2.1 Raport mbi rezultatet e anketimit Qershor 2017; Evidencën III.3 Ekstrakt tip anketimi për studentët në DSHUB; Evidencën III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor; në procesin e vlerësimit marrin pjesë strukturat, stafi dhe studentët.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	DSHUB aplikon për herë të parë për akreditimin e programit BSc. përmes vlerësimit të jashtëm. Ndërkohe, UBT është akredituar sipas këtij sistemi në vitet 2017 dhe 2021 (Ev. VI.2).
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore	Institucioni bazuar në Statut (Evidenca I.0, kreu IX, neni 79), në rregulloren e brendshme të UBT (Evidenca I.11, kreu IX, neni 66), në Rregulloren e DVBS/UBT (Evidenca I.4) ka parashikuar instrumentat për matjen dhe pasqyrimin e gjendjes së programeve të studimit. Matja e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	treguesve të mësimdhënies dhe kërkimit është mundësuar përmes hartimit të pyetësorëve të detajuar për studentët Evidenca III.2 Raport rezultatet e pyetësorit për student; Evidenca III.2.1 Raport mbi rezultatet e anketimit Qershor 2017; Evidenca III.3 Ekstrakt tip anketimi për studentët në DSHUB; Evidenca III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor. Përmes raportimit të veprimtarive në nivel njësie baze, fakulteti dhe universiteti (Evidenca I.25) kryhet promovimi i praktikave të mira, dhe nxitja e tyre.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UBT harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësite të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në UBT zyra përgjegjëse për hartimin, monitorimin, miratimin dhe marrjen e masave për përmirësim të programeve të studimit është DVBSB (Evidenca I.0; I.39, IV.1). Në bashkëpunim me DSHUB, dekanatin e FBU, Asamblenë e FBU, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë harton raporte periodike (Evidenca III.5 Raporti i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë 2021-2022) dhe po ashtu hartohen edhe raporte vjetore të UBT (Evidenca III.7) përmes të cilave bëhet plani i masave për përmirësim (Evidenca I.42. Vendim Dekanati për ndryshime në përmirësimin e programit të ciklit të parë BSc. në DSHUB).
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Komisioni i Sigurimit të Cilësisë harton raporte periodike (Evidenca III.5 Raporti i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë 2021-2022) dhe po ashtu hartohen edhe raporte vjetore të UBT (Evidenca III.7) përmes të cilave bëhet plani i masave për përmirësim (Evidenca I.42. Vendim Dekanati për ndryshime në përmirësimin e programit të ciklit të parë BSc. në DSHUB).
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si	Matja e treguesve të mësimdhënies dhe kërkimit është mundësuar përmes hartimit të pyetësorëve të detajuar për studentët (Evidenca III.2 Raport rezultatet e pyetësorit për student; Evidenca III.2.1 Raport mbi rezultatet e anketimit Qershor 2017;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Evidenca III.3 Ekstrakt tip anketimi për studentët në DSHUB); dhe vlerësimi të të dhënave e raportimit të tyre përmes raportimeve në të gjitha nivelet (Evidenca III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor; Evidenca I.29 Raport i analizës mësimore-kërkimore DSHUB 2021-2022).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Pranë dekanatit të FBU funksionon një grup ad-hoc për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programeve mësimore (Evidenca I.12 Rregullorja e FBU), i cili vepron bazuar në pyetësorët për studentët (Evidenca III.3 Ekstrakt tip anketimi për studentët në DSHUB) dhe pyetësorë për stafin akademik dhe ndihmës-akademik. Po ashtu, Zyra e karrierës përgatit në mënyrë periodike raportime mbi gjurmueshmërinë e punësimit të studentëve të diplomuar (Evidenca I.31). Mbështetur në sa më sipër, konkludohet se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstanton se UBT monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përshirja e aktorëve të brendshëm në sigurimin e cilësisë në programet e UBT është e rregulluar në dokumenta si Statuti i UBT (Evidenca I.0), Rregullorja e UBT (Evidenca I.11) dhe Plani Strategjik i UBT (Evidenca I.15). Përshirja e aktorëve të jashtëm ka të bëjë me procesin e vlerësimit të jashtëm përmes akreditimit dhe marrëveshjet me bizneset.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Detyrat për çdo aktor (studentë, staf, komisione, degë, zyra) në skemën e sigurimit të brendshëm të cilësisë bazohen në Rregulloren e DVBS (Evidenca I.4). Referuar evidencës 1.4, IAL ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë kryesore dhe njësitë bazë, personelin akademik, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. UBT garanton gjithashtu</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e institucionit njësia bazë dhe ajo kryesore përfshin stafin akademik, atë ndihmës, dhe administrativ në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë bazuar në rregulloret specifike (Evidencat I.12; I.13) dhe e ushtron veprimtarinë përmes hartimit të kurrikulës, ndjekjes (Evidencat I.21, I.22, I.23) dhe analizave vjetore (Evidencat I.25-I.29).			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Statuti i UBT parashikon respektimin e integritetit akademik dhe shmangjen e diskriminimit bazuar në Ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Evidenca III.4). Kjo realizohet në bashkëpunim nga Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë (Evidenca I.5 Rregullore e Këshillit të Etikës UBT, pika 8).			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës përmes shkëmbimit të eksperiencave me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe alumni, UBT ka organizuar aktivitete me operatorë private, biznese dhe përfaqësues të institucioneve publike (Evidenca I.33).			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UBT përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia dhe organizimi i veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin BSc. në SHUU janë bazuar në rregulloret specifike (Evidencat I.12, I.13) dhe e ushtron veprimtarinë përmes hartimit të kurrikulës, ndjekjes (Evidencat I.21, I.22, I.23) dhe analizave vjetore (Evidencat I.25-I.29) dhe veprimtarisë së DVBS (Evidencat I.0; I.39, IV.1). Informacioni i detajuar ofrohet gjithashtu nga website i UBT.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhëna personale.	Statuti i UBT publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhëna personale bazuar në Ligjin 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Evidenca III.4). Kjo realizohet në bashkëpunim nga Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë (Evidenca I.5 Rregullore e Këshillit të Etikës UBT, pika 8).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet	UBT monitoron, vlerëson (Evidenca III.2 Raport rezultatet e pyetësorit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	për student; Evidenca III.2.1 Raport mbi rezultatet e anketimit Qershor 2017; Evidenca III.3 Ekstrakt tip anketimi për studentët në DSHUB) dhe raportin në të gjitha nivelet (Evidenca III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor; Evidenca I.29 Raport i analizës mësimore-kërkimore DSHUB 2021-2022). Pjesë e raporteve është plani i masave për përmirësim të situatës.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sigurimi i efektivitetit mundësohet nga kontrolli periodik i ushtruar nga Komisioni për cilësinë dhe kurrikulat, i cili funksionon bazuar në Rregulloren e FBU (Evidenca I.13). Gjithashtu, raportimet periodike (Evidenca III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor) nga njësi bazë, dekanati, dhe miratimi në Senat janë hallka të sigurimit të efektivitetit të ndikimit të veprimtarive monitoruese.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Personeli dhe studentët mbahen të informuar mbi veprimtaritë për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit (RVB). Për këtë shërbejnë pyetësorët e detajuar për studentet (Ev. III.2 Raport rezultatet e pyetësorit për student; Evidenca III.2.1 Raport mbi rezultatet e anketimit Qershor 2017; Evidenca III.3 Ekstrakt tip anketimi për studentët në DSHUB; Evidenca III.5 Relacion i Komisionit të sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor). Përmes raportimit të veprimtarive në nivel njësi bazë, fakulteti dhe universiteti (Evidenca I.25) dhe publikimi në website-in e UBT i vendimeve të akreditimit aktual të UBT në 2017 dhe 2021, veprimtarive me studentët (Evidenca IV.3 UBT-Green).			
Konkluzione	<i>Gjetjet e GVJ janë që politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit në IAL, janë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:



1. Programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” është program i strukturuar për të mbështetur krijimin e specialistëve në fushat respektive, e në këtë mënyrë i shërben kërkesave të tregut të punës për këtë profil dhe interesit të të diplomuarve për të ushtruar profesionin e fituar.
2. Staf i akademik i Departamentit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” ka kualifikim të lartë, dhe përvojë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
3. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit ofron infrastrukturë (auditore, laboratore, mjedise për praktika mësimore, bibliotekë) të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit, dhe është në proces përmirësimi të vazhdueshëm të tyre (një godinë e re në shërbim të programit do të jetë funksionale në Shtator 2023, dhe biblioteka e UBT vijon të pajiset me mjete online dhe tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja).
4. UBT, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, kryen vlerësime periodike të cilësisë së mësimdhënies në Programin Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit”. Për këtë shërben sistemi i brendshëm i menaxhimit institucional plotësisht funksional në të gjitha nivelet.
5. UBT ka procedura dhe njësi të posaçme për këshillimin e studentëve, menaxhimin e nevojave të tyre gjatë viteve të shkollimit, dhe ndjekjen e nivelit të punësimit të tyre pas diplomimit.
6. Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, në koordinim me Fakultetin dhe Rektoratit, punon për të rritur më tej numrin e marrëveshjeve institucionale me universitete, institucione kërkimore (të huaja dhe vendore) dhe biznese, për të nxitur projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore dhe mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik (në mësimdhënie e kërkim).

Pika të dobta:

1. Numri në rënie i studentëve të regjistruar në program për vitin akademik 2022-2023.
2. Numri i studentëve të programit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” të përfshirë në projekte kërkimore është i reduktuar.
3. Numri i studentëve të Programit të Studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” të përfshirë në programet e mobilitetit është i reduktuar.

Rekomandime:

1. Referuar numrit në rënie të studentëve të regjistruar për vitin akademik 2022-2023, GVJ rekomandon planifikim më të kujdesshëm të metodave për informimin e të interesuarve mbi programin e studimit, dhe mbi nevojat e tregut të punës për këtë profil.
2. Rekomandohet përfshirje më e gjerë e studentëve të Programit të Studimit në projekte kërkimore.
3. GVJ rekomandon përfshirje më të gjerë të studentëve të Programit të Studimit Bachelor në “Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit” në programet e mobilitetit.



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Food and Nutrition Sciences" provided by the Higher Education Institution "Agricultural University of Tirana"

Strengths and affirmations


1. The Program BSc. in "Food and Nutrition Sciences" is a program structured to support the formation of specialists in the respective field, thus serving the demands of the labour market for this profile and the interest of graduates to practice their profession.
2. The academic staff of the Department of Food Sciences and Biotechnology engaged in the Program BSc. in "Food and Nutrition Sciences" is highly qualified and has experience in teaching and scientific research.
3. The Faculty of Biotechnology and Food has infrastructure (auditoriums, laboratories, facilities for professional practices, library), to fulfill the requirements of the study program, and is taking measures to improve it i.e. a new building in the service of the program will be operational in September 2023, and the AUT library is equipped with online tools and enriched with the books in Albanian and foreign languages.
4. Agricultural University of Tirana (AUT), the Faculty of Biotechnology and Food, in cooperation with the Department of Food Sciences and Biotechnology, conducts periodic evaluations of the teaching quality in the Program BSc. in "Food and Nutrition Sciences". To facilitate the process AUT has a fully functional internal institutional management system at all levels.
5. AUT has special procedures and units for advising students, managing their needs during their education years, and for tracking their employment after graduation.
6. The Department of Food Sciences and Biotechnology, in coordination with the Faculty and the Rectorate, works to further increase the number of institutional agreements with universities, research institutions (foreign and local) and businesses, to promote joint research-scientific projects and mobility of students and academic staff (for teaching and research).

Weaknesses

1. The decreased number of students enrolled in the program for the academic year 2022-2023.
2. The number of students participating in research projects is small.
3. The number of students participating in mobility programs is small.

Recommendations

1. Referring to the decreased number of students enrolled for the academic year 2022-2023, review team recommends a better planning of methods for the information of interested parties on the study program, as well as on the needs of the labor market for this profile graduates.
2. Review team recommends broader participation of the Study Program students in research projects.
3. Review team recommends broader participation of the Study Program students in mobility programs.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al